

ADRIATIKE LAMI

**LETËRSIA PËR FËMIJË PËRMES TREGUESVE GJUHËSORË
TË VEÇANTË**

Shpesh kur flasim për letërsinë e lidhim shpjegimin për të me kuptimin e mirëfilltë. Zakonisht kur flasim për letërsinë për fëmijë e lidhim atë me thjeshtësinë e dhënies së këtij kuptimi dhe dobinë që sjell kjo letërsi në botën e fëmijës.

Përkufizimi i marrëdhënies midis letërsisë dhe gjuhës përmes së cilës ajo konkretizon veten, shtjellohet si e tillë: përmes dhënies së idesë, emocionit, botës apo pjesës së botës që ajo përfaqëson, mënyrës se si e jep atë, fjalëve që zgjedh për ta paraqitur, kuptimin e drejtpërdrejtë që mbart, etj.

Shumë e rëndësishme në këtë proces është koha që i duhet një fëmije për të perceptuar secilën nga treguesit e mësipërm, kohë e cila në të vërtetë është e lidhur me gjatësinë e krijimit dhe me cilësinë e fjalës si pjesë apo si e tërë.

Perceptimi i kësaj gjuhe bëhet i veçantë pasi ajo i drejtohet një kategorie mjaft delikate, por ajo bëhet në të njëjtën kohë mjaft kontribuuese pasi ajo duhet të kryejë disa funksione.

Kjo gjuhë konceptohet në lëvizje dhe dinamikë, përpos edhe ndryshimeve shumë të shpeshta që pëson mosha e fëmijës.

Aspekte të kulturës gjuhësore në letërsinë për fëmijë.

I- Përgjigjen mbi pyetjen se ç'është letërsia na e jep Zhan Pol Sartri te vepra e tij: Ç'është letërsia; këtu ne arrijmë të marrim katër përgjigje:

- Çdo të thotë të shkruash.
- Përse shkruajmë?
- Për kë shkruajmë?
- Gjendja e shkrimtarit konvencionalisht në vitet1947.

Ajo që ka lidhje me temën tonë është mendimi i Sartrit mbi:

- fenomenin e perceptimit të emërtimit të objektit.
- kuptimin dhe domethënien e shprehjes.
- konvencionet e shenjave gjuhësore.

Këto janë të lidhura me shembujt e mëposhtëm:

Shembull 1: Ai thotë që perceptimi mbi mollën si objekt, është e lidhur me faktin që ajo është e gjelbër, por edhe me faktin që të jep kënaqësi, shije, nëpërmjet aciditetit.

Shembull 2: Por, në rastin kur themi që trëndafili i bardhë simbolizon besnikërinë, këtu nuk jemi duke folur më për trëndafilin si lule. Tashmë kemi parasysh emocionin e veçantë që përcjell analogjia e emërtimit të tij me konceptin etik.

Duke folur për rëndësinë që ka **gjuha në letërsi** Sartri e zhvillon idenë e tij, duke e përkufizuar gjuhën si “mburoja jonë”.

- Ekziston fjala e jetuar dhe ajo e takuar...

- Ajo që lidhet veçanërisht më letërsinë për fëmijë është se; fjala është një moment i veçantë i veprimit dhe nuk mund të kuptohet jashtë saj dhe nëse një shkrimtar nuk arrin të kryejë mirë sipërmarrjen për fjalën, atëherë ne i drejtojmë pyetjen përse ai shkruan?

II- Pak për shprehjen kulturë gjuhësore.

Për të parë marrëdhënien midis gjuhës dhe letërsisë për fëmijë është e nevojshme të njihet kuptimi mbi termin kulturë dhe lidhja e saj me gjuhën dhe elementet e gjuhës.

Fjala kulturë na shpie te vepra; “**Kultura dhe bumi**” i Jurih Llotman, sipas të cilit kultura është një marrëdhënie midis shumësisë dhe njëjtësisë. Kështu:

- Gjuha krijon botën e vet.
- Pyetja që lind sot është e lidhur me shkallën e përshtatshmërisë midis botës së krijuar nga gjuha dhe botës së krijuar jashtë saj.
- Kjo kulturë përfshin:

1- Gjuhën si komunikim

Duke e parë gjuhën si komunikim menjëherë shkojmë te:

- Skema e njohur e komunikimit, e cila është pjesë e letërsisë për fëmijë.

Kjo skemë përfshi;

- Tekstin, marrësin dhe dhënësin.

- Gjuhën dhe kodin.(Gjuha vetë është kodi plus historia e tij).

2 - Kultura është e lidhur me perceptimin e kuptimit.

- Nivelet e njohura të kuptimit jepën sipas taksonomisë së Blumit dhe në këto nivele përjashtohet abstragimi i mirëfilltë, për moshat e vogla.

3- Kultura e lidhur me botën e emrave të përveçëm:

Shembull: emri i personazhit të autores Astrid Lindgren; Pipi Çorapegjata.

Emri i saj i pazakontë është i lidhur me kuptimin që ai ka në gjuhën suedeze (Pipi = marrëzi, çmenduri).

III- Përgjigjen e dytë mbi gjuhën dhe konkretizimin e gjuhës në letërsi na e jep Aristoteli te vepra: **Poetika.**

Aristoteli e sheh gjuhën dhe letërsinë të lidhur me:

- Të menduarit (**efektet e fjalës**); frika, gjallëria, pasioni, mëshira, etj.
- Të folurit (**mënyrat e të shprehurit**) si; lutja, urdhri, pyetja, përgjigja, rrëfenja, etj.
- Elementët gramatikorë të të folurit; shkronja, rrokja, lidhësja, emri, folja, nyja, rasa, fjalia.
- Llojet e emrave.
- Cilësitë e të folurit; p.sh. qartësia.

IV- E lidhur me temën tonë është edhe debati i kohëve të fundit mbi kurrikulën e nivelit parauniversitar, debat i cili na çon në trajtesën midis dy shkencave; gjuhës dhe letërsisë. Me gjithë integrimin dhe bashkëjetesën e tyre,

Letërsia për fëmijë përmes treguesve gjuhësorë të veçantë

është e udhës të shihen edhe si specifika më vete, duke parë më pas ndikimin që ato kanë te njëra-tjetra. Kështu gjuha në këtë kontekst paraqitet si gjuhë e mirëfilltë dhe si stil:

- Gjuha si stil
- Gjuha si gjuhë

V- E lidhur me temën tonë është edhe pyetja:

A varet të kuptuarit e një letërsie për fëmijë nga fakti nëse vepra është e shkruar në shqipen standarde?

Përgjigjen për këtë e gjej në një trajtim të kolegut tim, Agron Tufa, i cili shprehet:

Që gjuhën e krijojnë kryesisht krijuesit. Meqenëse shkrimtari është i tillë, pra krijues, nuk mund t'i vihen kufij.

Natyrisht kjo nuk përjashton kriterin e kuptueshmërisë dhe thjeshtësisë për të cilën ka aq nevojë një letërsi për fëmijë. Megjithatë nuk mund të themi se një krijim i Mjedës është i papëlqyeshëm dhe i paqartë për fëmijët sa një krijim i Naim Frashërit. Dialekti nuk duhet të konceptohet si pengesë, ndalesë, moskuptim apo neglizhencë artistike.

VI- Si duhet të jetë gjuha në letërsinë për fëmijë?

Cilët janë disa tregues kulturorë të kësaj gjuhe?

Kjo gjuhë duhet të karakterizohet nga këto karakteristika:

• Zbatimi i normës letrare dhe i dialektit si pasuri komunikimi dhe rezultati artistik.

• Kontributet stilistike, sjellja e një gjuhe të figurshme.

• Gjuha si shumëkuptimshmëri, jo nëntekst por përmasë më e gjerë kuptimore. P.sh., përdorimi i fjalës fjala nënë.

• Gjuha si logjikë. Ndjekja e hapave dhe e niveleve të njohjes. Arsyetimi kalon natyrshëm nga e thjeshta te abstraktja. Fillimisht është emërtimi i sendit. Më pas përgjithësimi dhe më vonë kategorizimi. Shembull për këtë është kukulla Barbi. Kukulla. Lodra, etj.

• Fëmija si tregimtar, jo si shpjegues.

• Regjistri i gjuhës; jo gazetaresk, me ritëm.

• Përdorimi i fjalëve jo fjalë librore, jo fjalë me kuptim të përgjithshëm.

• Zbatimi i kërkesave pedagogjike dhe psikologjike.

• Gjatësia dhe lloji i fjalisë, që nënkupton: Fjalja e shkurtër, fjalja dëftore, fjalja habitore, fjalja pyetëse, fjalja kushtore, fjalitë e varura përdoren më pak, Nënteksti nuk rekomandohet.

• Përdorimi i emrave dhe foljeve dhe më pak përdorimi i mbiemrave dhe ndajfoljeve. Nuk rekomandohen ndajfoljet e prejardhura.

• Kujdesi me prapashtesat. Shumë të njohura janë emërtimet e të vegjëlve të kafshëve; arush, lepurush.

• Një vend të veçantë në letërsinë për fëmijë zë përdorimi i foljeve pasi fëmijët parapëlqejnë veprimin dhe fabulën rrjedhëse. Aq e dukshme është kjo sa shkrimtari i njohur Mopasan thotë:

“çfarëdo qoftë ajo që duam të themi s’ka veçse një emër për t’u shprehur, vetëm një folje për t’i dhënë gjallëri, dhe vetëm një mbiemër për t’u cilësuar. Duhet të kërkojmë pra gjersa ta gjejmë këtë emër, këtë folje e këtë mbiemër, e të mos kënaqemi me pothuajse...”

• Gjuha e letërsisë duhet të lidhet me faktin që vetë fëmijët në mosha të vogla përdorin të folurin e figurshëm. Kjo ndodh kur nuk njohin të gjitha fjalët. Në këtë rast atyre u vjen në ndihmë procesi i animizmit dhe fantazia.

Ata shpesh thonë: flenë autobusët, nuk thonë parko, por fle (A Bishqemi).

• Ekonomia gjuhësore, në këtë rast nuk vjen nga njohja e parimit të koncizitetit, por nga sasia e leksikut të zotëruar.

• Ja sa fjalë di dhe mund të përdorë një fëmijë sipas grupmoshave;

- 1, 5 vjeç = 10-15 fjalë
- 2 vjeç = 300 fjalë
- 3 vjeç = 1500 fjalë
- 4 vjeç = 2500 fjalë

Kështu fjalori i fëmijëve është i kufizuar: një shembull është fëmija që tregon përrallën nëna dhia dhe kecat në një mënyrë të shkurtuar.

Para disa vitesh, im bir tregonte në moshën 2 vjeçare kontributin e tij në rrëfimin e përrallës. Ne mendonim mbi “talentin” e tij të veçantë. Ajo që na bënte përshtypje ishte se ai kalonte shumë shpejt në fund të përrallës, pikërisht te pjesa “bum te tazani”, pra në pjesën kur ujku bie në kazanin me ujë të nxehtë. Atëherë unë mendoja se kjo ishte vetëm e veçanta e tij, që karakterizohej nga konciziteti. Në fakt intelekti i tij zotëronte një numër të kufizuar fjalësh të cilat realizonin panoramën e këtij prezantimi.

VII- Tregues i veçantë i kulturës së gjuhës në letërsinë për fëmijë është gjuha e revistave dhe e botimeve të ndryshme për fëmijë, të cilat në të vërtetë sot paraqesin mjaft probleme, të lidhura kryesisht:

- Me thjeshtësinë dhe kuptueshmërinë.
- Me parimin etik dhe estetik.
- Me përdorimin e fjalëve të tepërta, kryesisht në poezi.
- Me përdorimet e bezdisshëm të emrave prejfoljorë.
- Me përdorimin e shumë emrave rresht, njëra pas tjetrës.
- Me mungesën e përzgjedhjes së fjalëve.
- Me përdorimin e fjalëve të vështira, arkaizmave, barbarizmave, neologjizmave etj.
- Me renditjen në fjali, në mënyrë jo të kujdesshme.
- Me ngarkesën e përgjithshme që pengon kuptimin dhe shijen estetike.
- Me mungesën e profesionalizmit në përkthime etj.
- Në fushën e kulturës së gjuhës për fëmijë, sot mungojnë fjalorët moshorë dhe shpjeguesit e vërtetë funksionalë që do të ndihmonin të rriturit në punën me të vegjlit.

Letërsia për fëmijë përmes treguesve gjuhësorë të veçantë

• Por sot, lidhja midis gjuhës (fjalës si pjesa kuptimore dhe stilistike e saj) dhe letërsisë është aq e dukshme, sa një pjesë e përmbledhjeve të viteve të fundit emërtohen “Magjia e fjalës”.

VIII- Gjuha duhet të konceptohet si vlerë. Por për këtë, ne duhet të njohim disa cilësi dhe kërkesa të saj. Xhevat Loshi kur flet për kërkesat dhe cilësitë e komunikimit ka parasysh edhe komunikimin letrar i cili duhet:

- T’i përshtatet përmbajtjes.
- T’i përshtatet qëllimit.
- T’i përshtatet auditorit.
- Të realizojë një gërshetim të kulturës së të menduarit me kulturën e gjuhës.

Cilësitë e këtij komunikimi janë:

- Qartësia
- Përpikmëria
- Ngjeshja me përmbajtjen
- Pasuria e fjalorit
- Pastërtia e gjuhës

Në letërsinë për fëmijë, kultura gjuhësore, është ndihmësja kryesore e zbatimit të kërkesave pedagogjike të kësaj letërsie, e prezantimit dhe konkretizimit të këtyre kërkesave, disa prej të cilave janë:

- kërkesa për përshtatje tematike
- kërkesa për përshtatje moshore
- kërkesa për përshtatje psikologjike
- kërkesa për përshtatje moralizuese
- kërkesa për përshtatje etike
- kërkesa për përshtatje estetike
- kërkesa për krahasim
- kërkesa për dedikim
- kërkesa për rrethanat kohore e historike
- kërkesa për referim mbi një ngjarje
- kërkesa për vetërrëfim
- kërkesa për larmi
- kërkesa për besim
- kërkesa për model
- kërkesa për standard
- kërkesa për imitim
- kërkesa për argëtim
- kërkesa për njohje
- kërkesa për edukim
- kërkesa për zbavitje

Kjo kulturë kultivon vlerat kryesore të letërsisë të cilat janë:

- njohëse

- **artistike**
- **edukative**
- **argëtuese**

* Mbi të gjitha kultura gjuhësore në letërsinë për fëmijë duhet të karakterizohet nga gjetja e përgjigjeve të mundshme dhe të thjeshta. Shumë shpesh në matjen që u bëhet njohurive letrare të fëmijëve tanë, ne shohim se shpesh ata japin përgjigje të gabuara. Pyetjet që shtrohet janë:

- Janë përballë një fakti letrar të vështirë?
- Janë përballë një fakti gjuhësor të vështirë?

Në një nga testet e Pisa, fëmijët shqiptarë nuk u ishin përgjigjur pyetjeve mjaft të thjeshta.

Shembull: Fabula nga Ezopi. “Djali dhe Luani”.

Në mënyrë përmbledhëse na duhet të pranojmë se sot kultura gjuhësore me gjithë zhvillimin e ndërmarrë paraqet probleme të këtij zhvillimi, të cilat lidhen me aspekte mungesore, por edhe me reflektime të dobëta kundrejt kërkesave që shtron vetë letërsia dhe vetë auditori, të cilit kjo lloj letërsie i drejtohet. Kjo gjuhë akoma është në kërkim të larmisë, dhe të konceptimit si pjesë tradite apo si perceptim bashkëkohor i realiteteve perceptive.

LITERATURA e përdorur:

Çështë letërsia: Zhan Pol Sartri.

Kultura dhe Bumi; Jurij Llotman.

Hyrje në teorinë e letërsisë: Astrit Bishqemi.

Gjuha dhe Jeta: Xhevat Lloshi.

Poetika: Aristoteli.

E drejta e krijuesit në diskursin mbi gjuhën; Agron Tufa.